



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit*, Kryetarja, Ekaterina Trendafilova, më 6 qershor rrëzoi kërkesën e dorëzuar nga z. Thaçi më 28 maj për zëvendësimin e gjykatësit Nikola Giju ose, si alternativë, heqjen e tij si Gjykatës i Vetëm, sepse është caktuar si gjykatës në një situatë të referuar për hetim në Gjykatën Penale Ndërkombëtare.

Kryetarja njoftoi se më 6 qershor gjykatësi Giju dha dorëheqjen nga Regjistri Gjykatësve Ndërkombëtarë dhe po të njëjtën ditë Kryetarja caktoi gjykatësen Marzhorie Masëlo (Marjorie Masselot) për të zëvendësuar gjykatësin Giju si Gjykatës të Vetëm në këtë proces gjyqësor. Kryetarja vuri në dukje se, për rrjedhojë, kërkesa për zëvendësimin e gjykatësit Giju është e tejkaluar dhe kërkesa alternative për heqjen e tij nuk është e nevojshme të trajtohet.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për datën 24 qershor në orën 9:00 të mëngjesit.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

